PËR LËSHIM TË MENJËHERSHËM
[19.09.2007]
Zyra për shtyp: +389 (0)2 308-0446
Celulari: +389 (0)70 367 547
Email: bvelickovska@usaid.gov
http://macedonia.usaid.gov

KUMTESË PËR SHTYP

Programi i USAID-it po ndihmon që të sjellë UEJL-in nga koncepti në një Universitet me nivelin më të avancuar teknologjik

Studentë nga Maqedonia dhe rajoni po përfitojnë nga arsimimi i lartë me cilësi të përmirësuar në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL) duke i falënderuar Projektit për lidhje të arsimit të lartë (HELP) të USAID-it. Projekti filloi në vitin 2001 kur u themelua UEJL dhe ka qenë partneritet midis USAID-it, Universitetit të Indianës dhe UEJL-it. Projekti HELP ka qenë i dobishëm në ndihmën që e ka dhënë që universiteti të rritet nga koncepti në një universitet me nivelin më të avancuar teknologjik me 7000 studentë në vetëm gjashtë vite.

“Tregimi i UEJL-it, ngritja e tij për tu bërë shembull për universitetet tjera në rajon, është diçka për të cilën të gjithë duhet të mburremi,” tha ambasadorja e ShBA-ve Xhillian Millovanoviç.

Projekti HELP përforcoi kapacitetet institucionale të universitetit, i përmirësoi standardet akademike dhe kapacitetet e mësimdhënies në fakultetet e Administratës së biznesit dhe Shkencat e komunikimit dhe teknologjisë dhe futi qendrën e parë arsimore për mësim në distancë në Maqedoni, duke përfshirë dhe një laborator multimedial të teknologjisë së lartë. Veç kësaj, u ndanë nëntë bursa për magjistraturë për studentët për në Universitetin e Indianës.

“Dëshiroj që të falënderoj personalisht Ambasadën e ShBA-ve dhe USAID-in për ndihmën që të bëhemi ajo që jemi tani, një nga Universitetet më të mira në rajon,” tha Rektori i UEJL-it zotëri Abazi.

Një qendër për Zhvillim të biznesit, për Mbështetje të mësimdhënies dhe Qendra për shërbime të karrierës u krijuan përmes këtij projekti për të përforcuar punën e mësimdhënësve dhe studentëve dhe për të krijuar lidhje të ngushta me bashkësinë e biznesit të vendit dhe atë ndërkombëtare. Secila nga këto qendra zhvilloi një portofol me aktivitete dinamike, kryesisht të fokusuara në zhvillimin e kapacitetit njerëzor. Veç kësaj, Qendrat kanë bashkëpunuar për të krijuar një program mësimor trevjeçar për diplomë në Shkencat shoqërore në pajtim me Marrëveshjen e Bolonjës.

SHËNIME PËR REDAKTORËT:
Populli amerikan, përmes USAID, ka investuar më shumë se 450 milionë dollarë në Maqedoni që nga viti 1993. Aktualisht janë duke u zbatuar më shumë se 25 projekte me vlerë prej më shumë se 25 milion dollarë në vit. Këto projekte kanë për qëllim të përkrahin kalimin e Maqedonisë kah një demokraci multietnike të bazuar në treg të lirë. Këto përfshijnë iniciativa për përshpejtimin e rritjes ekonomike, zhvillim të institucioneve demokratike dhe arsimimin e qytetarëve për një ekonomi moderne. USAID siguron ndihmë ekonomike dhe humanitare në më shumë se 100 shtete. Për më tepër informata vizitoni http://macedonia.usaid.gov.